Nr X-1040 Datum 01.12.2021

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria e Arsimit

**Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, te Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative të MASHT-it,MASHTI,nr.17/2009, nr.5/2021, dhe kërkesën me nr. -X-1017 , e datës 30.11.2021, Drejtoria e Arsimit me datë 01.12.2021, shpall :**

**KONKURS**
( Për plotësimin e vendit të punës)

**I.SHFMU "Naim Frashëri " në Breznicë**
**Vendet e punës:**

1.Një mësues klase , zëvendësim i pushimit të lehonisë
2.Një mësimdhënës i TIK-ut me 16 orë , zëvendësim i pushimit mjekësor
3.Një mësimdhënës për edukatë fugurative me 14 orë, prej tyre 8 orë në Breznicë e Kozaricë dhe 6 në Gjimnazin "17 Shkurti " në Obiliq

**II.SHMLP"Ismail Dumoshi " në Obiliq**
**Vendi I punës:**

1. Një mësimdhënës për ekonomi me 19 orë , zëvendësim i pushimit të lehonisë

**III.Gjimnazi "17 Shkurti " në Obiliq**
**Vendi i punës:**

1. Një mësimdhënës i matematikës,zëvendësim i pushimit të lehonisë

**Kushtet për mësimdhënës :**

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ(MASHT), nr.5/2021.

Kandidatët që konkurojnë për mësimdhënës duhet ta sjellin kopjen e diplomës së fakultetit të vërtetuar apo noterizuar ,vërtetimin për përvojën e punës, cerifikatën e lindjes, dokumentin e letërnjoftimit.

Kandidatët,që konkurrojnë për këto vendet e punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostifikuara në MASHTI nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Fletëkërkesat merren në Zyrën e Pranimit të KK-së,apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njejtën zyrë.Kandidatët do të ftohen në inervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë ngä dita e publikimit në shtyp dhe te faqja zyrtare e komunës.

Drejtori : Rexhep Zeka ____________

# #VAKSINOHU



Vaksinimi mund të bëhet në cilëndo
qendër të vaksinimit, pa termin të caktuar
paraprakisht, pavarësisht vendbanimit,
për të gjithë qytetarët nga mosha 12 vjeç e lart.
Orari i punës 07:00 – 19:00, e hëne – e premte.